



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 28 shtator 2018, në mbledhjen e V-të (pestë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Valbona Kadriu Podvorica, Zëvendës kryesuese e Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Bashkim Sylja, Valmire Lahu, Albina Avdiu, Radisav Perović dhe Mefail Rama, ndërsa për shkaqe shëndetësore mungoi, z. Shaban Ahmeti Kryesues i Komitetit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Agim Blakçori Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Xhavit Fejza dhe Nevzat Qorolli, përfaqësues të UNMIK-ut, Bashkim Bajrami Policia Kufitare, Përparim Shala përfaqësues i OSBE-së, si dhe përfaqësues i KFOR - LMT.

znj. Valbona Kadriu Podvorica, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj për arsyen e kryesimit të kësaj mbledhje për shkak të mungesës së kryesuesit të komitetit i cili për shkaqe shëndetësore nuk ka mund të marrë pjesë në këtë mbledhje, duke i njoftoj edhe rreth pikave të rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27 korrik 2018

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës.

2. Përgatitjet e nxënësve të Komunitetit jo shumicë për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019 në Komunën e Podujevës.

znj.Valbona Kadriu Podvorica, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës prezent në mbledhje kemi edhe U.D. drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili mund të na jep një informatë rreth kësaj teme.

z.Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, paraqiti informatë rreth përgatitjeve të nxënësve të komuniteteve jo shumicë, për fillimin e vitit të ri shkollor, ndër të tjera theksoi, jemi në dijeni se në Komunën e Podujevës kemi një traditë të mirë me nxënësit e komunitetit jo shumicë pavarësisht diferencave që kanë, janë të përfshirë në sistemin e rregullt të arsimit pa kurrfarë ndarjesh por janë pjesë e barabartë e të gjithë bashkëmoshatarëve të tyre. Në bazë të informatave të siguruar nga drejtorët e shkollave, këtë vit kemi regjistruar 17 nxënës në klasa parafillore, klasën e parë do ta vijnë 23 nxënës, klasën e dytë janë 17 nxënës, klasën e tretë janë 24 nxënës, klasën e katërt janë 19 nxënës, klasën e pestë janë 7 nxënës, në klasë të gjashtë janë 21, në klasë të shtatë 13, në klasë të tetë 17 nxënës dhe në klasën e nëntë janë 14 nxënës, ndërsa në klasën e dhjetë deri tani janë regjistruar 12 nxënës, në klasën e njëmbëdhjetë janë 8 nxënës dhe në klasë të dymbëdhjetë janë 13 nxënës, pra gjithsejtë në shkollat e Komunës së Podujevës janë 195 nxënës të komunitetit jo shumicë, kryesisht rom – ashkalinj, të cilët në të gjitha nivelet vijnë shkollimin në vitin 2018. Po ashtu dëshiroj t’ju njoftoj se Drejtoria e Arsimit tash e sa vite ndan tekstet shkollore të arsimit të mesëm për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe në kontekst edhe këtë vit jemi shumë afër me procedura që t’i shpërndajmë. Pastaj edhe sa i përket ndarjes së bursave për nxënës dhe student ne gjithherë ju japim përparësi nxënësve të Komuniteteve jo shumicë e që edhe vit kanë qenë përfitues një numër i tyre.

z.Bashkim Sylja, theksoi, falënderoj drejtorin para folës për informatat e dhëna, dhe kam pyetje, a keni informata se sa është numri i nxënësve të komuniteteve jo shumicë që nuk e vijnë mësimin, si dhe pyetja tjetër ka të bëjë me tekstet shkollore që u cekën, përse nuk zhvillonin procedurat më herët ndoshta 1 muaj para se të filloj mësimi dhe të njëjtat të sigurohen.

z.Agim Blakçori – DKA, theksoi, sa i përket vijimit ose mos vijimit të nxënësve të komuniteteve, ne si Drejtori kemi themeluar Ekipin komunal për parandalimin e braktisjes së shkollimit dhe po ashtu secila shkollë ka të themeluar një ekip të tillë me qëllimin e vetëm që të përfshihen të gjithë fëmijët në procesin e shkollimit dhe asnjë të mos mbetet jashtë këtij procesi. Gjithashtu si Drejtori kemi bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e Komuniteteve dhe unë sa kam informacione fëmijët e komuniteteve janë duke vijuar mësimin, andaj nëse ndokush ka dijeni për ndonjë rast që nuk vijon mësimin të na njoftoj sepse ekipet e cekura kanë për obligim të ndërmarrin të gjitha masat që ata fëmijë të fillojnë shkollimin, kështu që për momentin nuk kemi informacione se ka ndonjë fëmijë jashtë procesit mësimor.

Sa i përket sigurimit të teksteve shkollore për nxënësit e komuniteteve të shkollimit të mesëm, janë zhvilluar të gjitha procedurat dhe besoj se në javën e ardhshme ato tekste do t’ju shpërndahen nxënësve të komunitetit jo shumicë.

znj.Doruntina Hasani, pyetje para folësit, a mund të ndërmerret diçka që viteve të ardhshme tekstet në fjalë të sigurohen dhe të shpërndahen me fillim të vitit shkollor e jo të ndodh sikur tani kur jemi afër një muaj nga fillimi i vitit shkollor dhe ende nuk janë shpërndarë.

z.Agim Blakçori – DKA, rreth çështjes së ngritur nga para folësja besoj se do ta kemi parasysh këtë dhe viteve të ardhshme me kohë do të zhvillojmë procedurat dhe do të sigurohen dhe shpërndahen me kohë tekstet shkollore në fjalë për nxënësit e shkollimit të mesëm të komunitetit jo shumicë.

z.Liman Zeqiri, shëf i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK, theksoi, fillimisht ju njoftoj se para dy ditëve isha tek lagja ku jeton një pjesë e komunitetit ashkalinj dhe dhurova një donacion një personi i cili merret me një veprimtari muzikore, donacion nga organizata IOM që ka vlerën 5,000,00 €, fjala është për Lulzim Ahmetin i cili ishte përfitues i donacionit i pajisjeve muzikore, me që rast edhe mora informatat se Kryesuesi i këtij Komiteti z.Shaban Ahmeti nuk është mirë me shëndet dhe është shtrirë për trajtim në QKUK – Prishtinë.

Sa i përket temës, është kënaqësi që e kemi prezent këtu U.D. Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, dhe ne mund të diskutojmë të japim vërejtje, ide, kritika etj, mirëpo realiteti sa i përket Komiteteve në Komunën e Podujevës, mund të them se pothuajse që 4-5 vite radhazi Komuna e Podujevës është shembull në Kosovë sa i përket ndihmave për nxënës të komuniteteve jo shumicë të cilët vijojnë shkollimin nga klasa e X-të ose siç quhet shkolla e lartë e mesme, ku të gjithë nxënësve në fjalë Komuna jua dhuron të gjitha tekstet dhe pajisjet tjera mësimore, dhe për këtë i gjithë falënderimi i shkon Drejtorisë së Arsimit, gjë e cila nuk ndodh në Komunat tjera, por duke falënderuar edhe Kryesuesin e Komitetit për Komunitete z.Shaban Ahmeti i cili gjithnjë ka insistuar t’iu ndihmoj nxënësve të Komunitetit jo shumicë madje ka bërë edhe gjeste humane ku edhe atyre nxënësve të komunitetit shumicë rreth 50-60, të cilët nuk kanë pasë mundësitë materiale për të blerë tekstet shkollore, ju ka mundësuar që edhe ata të përfshihen në emër të komuniteteve jo shumicë dhe të jenë përfitues, fjala është për ata nxënës me gjendje të rënë ekonomike-sociale, andaj edhe e them se duhet të jemi mirënjohës dhe falënderues ndaj z.Shaban Ahmetit. Sa jam i informuar kemi rreth 75 kërkesa për tekste dhe pajisje shkollore për nxënës të arsimit të mesëm të lartë, procedurat janë zhvilluar dhe besoj se shumë shpejt do të kemi edhe realizimin e kërkesave në fjalë, dhe ky është viti i katërt që realizohet një ndihmë e tillë. Çështje tjetër e cila është shumë e rëndësishme, në emër të ZKKK me përgjegjësi të lartë falënderoj edhe OJQ-në “Qëndrimi” e cila merret enkas me fushën e arsimit për fëmijët e komuniteteve jo shumicë. Unë personalisht por edhe në kuadër të ZKKK-së gjithëherë jam munduar me të gjitha kapacitete humane dhe në bazë të përgjegjësi që kam që sa më shumë ta ndihmoj arsimin në shumë aspekte dhe pa kurrfarë dallimesh veçmas komuniteteve jo shumicë, sa për njoftim, nga 12 shtatori deri më sot kam lëshuar 28 vërtetime nxënësve të komuniteteve jo shumicë për kompletimin e dokumentacioneve të tyre për konkurrim për bursa e që përveç bursave të ndara nga Komuna për ata nxënës të cilët konkurrojnë e që unë gjithëherë në bazë të të drejtës time legjitime që kam interferoj në këtë aspekt, mirëpo ata nxënës kanë edhe një hapësirë tjetër shtesë që përmes OJQ-së “Voice of Roma” e cila është organizatë ndërkombëtare Zvicerane e cila që 4 vite shpërndan bursa shkollore për nxënës të komuniteteve jo shumicë të cilëve natyrisht që paraprakisht ju kërkohet dokumentacioni i nevojshëm e që ne si ZKKK iu lëshojmë vërtetimet e përkatësisë kombëtare dhe unë kam për obligim të marrë një deklaratë nga përfaqësuesi i lagjes përkatëse, letërnjoftimet e prindërve dhe të gjitha të dhënat tjera të nxënësit, ndërsa kanë qenë dy kërkesa të studentëve që për regjistrimin e semestrit duhet të paguhen taksa përkatëse mirëpo në rastet në fjalë atyre ju nevojiten vërtetime nga ZKKK dhe në këtë kuptim kam lëshuar edhe 2 vërtetime të tilla që personat përkatës i takojnë komunitetit ashkalinj, dhe sa për transparencë 26 nxënës janë të komunitetit ashkalinj, dhe 2 nxënës të komunitetit rom si dhe janë 2 studentë që kanë kërkuar vërtetime të tilla për bursa, që do të thotë se kemi 30 raste të tilla. Pra këtë që e bëjmë ne si Komunë, në një mënyrë e kemi edhe obligim moral, institucional dhe shtetërorë sepse jetojmë në shtete ku të gjithë duhet të trajtohen njësoj e në këtë rast edhe komuniteteve jo shumicë, për integrimin e tyre në shoqëri dhe ndihmë ndaj rasteve ekonomike sociale etj, ngase fundja unë asnjëherë nuk i tërhiqem fjalës se e kam problem t’i ndaj komunitetet ngase jemi të gjithë të barabartë në këtë shtet pavarësisht gjuhës, kombësisë, fesë, bindjeve të ndryshme etj.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, paraprakisht shtrova pyetje, mirëpo nuk e thash se nuk e vlerësojmë Komunën për shpërndarjen e teksteve shkollore për nxënësit e komunitetit ashkalinj të cilët vijnë në mësimet në shkollimin e mesëm të lartë, andaj pyetja përkatësisht kërkesa ishte që viteve të ardhshme procedurat të zhvillohen më herët për shkak se atyre nxënësve ju nevojiten për të ndjekur mësimin paralelisht me të tjerët, kur e them këtë e bazoj edhe në faktin që ne kemi qenë nxënës dikur dhe natyrisht jemi në dijeni se të vijosh mësimin për afër 1 muaj pa tekste shkollore është shumë gjatë sepse mbarojnë disa njësi mësimore dhe në qoftë se humbet motivi i nxënësve pastaj është pak më problem.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, pajtoj plotësisht me parafolësen sepse vërtetë ajo që e potencoj qëndron ashtu, edhe pse ndoshta kompetent për të dhënë përgjigjen është Drejtoria e Arsimit, mirëpo, jo për tu lavdëruar, por ju rikujtoj se Komuna e Podujevës ka marrë edhe mirënjohje në kuptim të shërbimeve të kryera për komunitetet jo shumicë, e them këtë duke pasë parasysh se në shumicën e Komunave janë kriteret e përcaktuara dhe në të cilat nuk mund të ndërhyj askush, dhe në këtë aspekt sigurisht jeni në dijeni për numrin e madh të atyre nxënësve të cilët janë duke pritur për regjistrim në shkollat e mesme dhe pothuajse që 1 muaj kanë mbetur jashtë procesit mësimor, ndërsa në anët tjetër kam qenë i detyruar të interferoj që asnjë nxënës i cili ka dashur të regjistrohet në shkollat e mesme nuk ka mbetur jashtë procesit mësimor pavarësisht kuotës, dhe ky lirshëm mund të quhet privilegj për nxënësit e komunitetit jo shumicë, me të vetmin qëllim që nxënësit e komuniteteve në fjalë të integrohen dhe të mos mbeten të paarsimuar dhe rrugëve.

z.Mefail Rama, theksoi, fillimisht si përfaqësues i komunitetit rom falënderoj z.Liman Zeqirin shef i ZKKK, Drejtorin e Arsimit dhe Komunën e Podujevës në përgjithësi për vullnetin dhe punët që kanë bërë deri tani për nxënësit e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, mirëpo dëshiroj të sqaroj rreth asaj që parafolësi e tha se ne si komunitet shqiptar kemi qenë të shtypur dhe tani përkundër asaj ne i mbrojmë komunitetet jo shumicë, unë ju them se edhe fati jonë si komunitet jo shumicë ka qenë i njëjtë me fatin e komunitetit shumicë sepse edhe ne kemi qenë të shtypur në regjimet e mëhershme kështu që në këtë aspekt nuk kemi pasë kënaqësinë e arsimit dhe ata mësimdhënës që janë më të vjetër në moshë dhe që kanë qenë arsimtar para luftës me siguri se janë në dijeni se ka qenë numri i nxënësve të komuniteteve jo shumicë, mirëpo tani në këtë kohë unë personalisht nuk e ndjej vetën si pakicë në Komunën e Podujevës për shkak se asnjëherë nuk jemi diskriminuar qoftë në fushat e sigurisë, lëvizjes së lirë, arsimit dhe gjitha sferat tjera të jetës jemi të barabartë, dhe këtë e them me plotë përgjegjësi. Pra edhe njëherë e përsëris se edhe ne si Komunitet e kemi pasë fatin e njëjtë dhe diskriminim e njëjtë ashtu siç e kanë pasur edhe komunitetit Shqiptar në regjimin e mëhershëm, andaj ne mundohemi dhe punojmë bashkërisht për këtë shtet, ta ndërtojmë këtë shtet dhe të jetojmë në këtë shtet. Konsideroj se nëse një nxënës i cilit do komunitet qoftë ai është i paarsimuar, si fenomen e shohë të dëmshëm për shoqërinë tonë dhe dëm për të ardhmen tonë, kështu që ne duhet të mundohemi të edukojmë dhe arsimojmë fëmijët tanë dhe në këtë aspekt kërkoj edhe nga Drejtoria e Arsimit që të shtrëngojnë paska arsimin në mënyrë që nga shkollat të ketë kudra të vërtetë e jo të ketë vetëm arsimim me nota dysha ose tresha vetëm sa për të kaluar klasën, por të kenë dituri sepse nuk është gjë pozitive vetëm nota, kalimi i klasëve, vijimi në shkollë e të ngjashme sepse pastaj po merren diploma dhe asgjë, por të kultivohet sa më shumë dituria.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, unë isha i singertë në këtë temë dhe integrimin e komuniteteve jo shumicë në shoqëri. Ne jemi në dijeni për të gjitha që i kanë ndodh këtij populli në të kaluarën, mirëpo konteksti ishte që ne pastaj kemi vazhduar bashkëjetesën të gjithë si një

popull dhe asnjëherë nuk kemi pasur probleme ves vete dhe si shef i ZKKK gjithherë jam munduar dhe do të vazhdoj t'iu ndihmoj.

znj.Valbona Kadriu Podvorica, theksoi, konsideroj se diskutimet dhe të dhënat që u dhanë rreth kësaj teme ishin të mjaftueshme, andaj meqë nuk ka anëtarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e konsideroj të mbyllur këtë pikë të rendi të ditës.

3. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.55'

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-0079371/18
Podujevë,
28 shtator 2018**

**zëvendës kryesuesja e Komitetit
Valbona Kadriu – Podvorica**
